

SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS



# PËRGJEGJËSIA SOCIALE

JANAR-MARS 2019



 **CREDINS bank**  
Ne flasim gjuhën tuaj!

AKTIVITETET E NDËRMARRA DHE MBËSHTETURA NGA CREDINS BANK, NË KUADËR TË PËRGJEGJËSISË SOCIALE NË PËRPUTHJE ME 17 OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM.

OBJEKTIVI 3

## SHËNDET I MIRË DHE MIRËQËNIE

*Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe!*

- Credins Bank mbështet “Fondacionin e Fëmijëve Shqiptare, Dominic Scaglione” për të disatin vit rradhazi. Banka ofruar mbështetje financiare për qendrën për zhvillimin e fëmijëve me probleme autike. Përmes kësaj mbështetjeje Credins, synon të kontribuojë në sensibilizimin e një komuniteti në nismat për shëndet dhe mirëqenie.
- Credins Bank, mbështeti Kryqin e Kuq Shqiptar jo vetëm në dhurimin vullnetar të gjakut por edhe për projektet sociale në ndihmë të fëmijëve jetim, të moshuarve në nevojë.



## INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË

*Ndërtimi i një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit përfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit.*

- Credins Bank, ka investuar dhe zhvilluar politika për mbështetjen me financim të projekteve në përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve jetësore. Banka, mbështeti Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” duke mbuluar shpenzimet për blerjen e 15 aparatave mjekësore për ambientet e kësaj poliklinike si dhe Spitalin Rajonal Shkodër për mbulimin e shpenzimeve për përmirësimin e infrastrukturës së spitalit.
- Credins Bank, në kuadër të përkujdesjes të vazhdueshme për mirëqënie, progresit dhe zhvillimit të mjedisit ku ushtron aktivitetin e saj, dhuroi pajisje zyre në përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve: Fondacioni Firdeus dhe Spitalin Rajonal Vlorë
- Në kuadër të Përgjegjësisë Sociale, përkujdesjes ndaj ambientit dhe komunitetit, Credins Bank mbështeti Bashkinë Tiranë në restaurimin e lulishtes dhe këndit të ri të lojrave pranë stadiumit “Arena Kombëtare” në Tiranë organizuar në datën 27 Janar 2019. Iniciativë e cila kontribuon në ndërtimin e hapësirave publike të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të gjelbërta.



## PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT

*Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm.*

- Credins Bank, në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ftuan të gjitha studentët, të cilët kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve “Bachelor”, të bëheshin pjesë e Programit Kombëtar të Punës. Credins mbështeti këtë iniciativë e cila nxit punësimin e të rinjve dhe zhvillimin profesional ndërkohë, në punën e përditshme, Credins, krijon produkte dhe ofron shërbime bankare të cilat orientojnë të rinjtë drejt plotësimit të ëndrrave dhe nevojave të tyre.
- Credins Bank mbështeti ExpoCity në organizimin e AGRO-TECH Expo & Forum 2019. Credins Bank është një aktor i rëndësishëm në ndërtimin e një komuniteti aktiv dhe qyteteve me zhvillim të qëndrueshëm, duke investuar në aktivitete promovuese të agrozotizimit në të gjithë vendin.

